

Date 22.12.2025

Procesverbal - Tipi i kontratës - Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**Objekti i procedurës: “ Rikonstruksion i linjës së transmetimit Dn-900 mm gizë , linja
Bovillë- Impiant”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV Gize 14711100-9, Fllanxhat 44167110-2)

Vlera e fondit limit: : 1.592.771,98 (nje milion e peseqind e nentedhjte e dy mije e shtateqind e shtatedhjte e nje presje nentedhjte e tete) **Monedha, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar me VKM-në nr.714, datë 24.11.2021 autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;përkatësisht 31.855, 4 (tridhjte e nje mije e teteqind e pesedhjte e pese)..

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomiko-financiar

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2.2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006.

”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2025).**

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kështëve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet përkatësisht të kryera gjatë tri viteve të fundit (përlllogaritur nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës)

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë punën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- NP – 1 A *Punime gërmimi në tokë;*
- NP – 2 A *Ndërtime civile dhe industriale;*
- NP – 4 A *Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;*
- NP – 7 A *Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje;*

Per punimet speciale të ndërtimit:

- NS – 1 A *Punime për prishje të ndërtimeve;*

Sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentim : Kërkesa për paraqitjen e licencës profesionale të vlefshme, për kategoritë përkatëse të punimeve objekt kontrate, është e domosdoshme për të garantuar se operatori ekonomik është i autorizuar ligjërisht për ushtrimin e veprimtarisë së ndërtimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ky kriter garanton zbatimin korrekt dhe cilësor të punimeve dhe sigurinë teknike të tyre.

NP – 1 A – Punime gërmimi në tokë

Vendosja e kësaj kategorie justifikohet pasi realizimi i objektit përfshin: Gërmime lineare përgjatë gjithë gjurmës së linjës së transmetimit DN-900 mm; Gërmime në thellësi të ndryshme për vendosjen e tubacionit dhe elementëve shoqërues; Punime stabilizimi dhe mbrojtjeje të kanalit të gërmimit.

Punimet e gërmimit janë pjesë përbërëse dhe e domosdoshme e kontratës dhe pa këtë kategori nuk mund të realizohet objekti.

NP – 2 A – Ndërtim civil dhe industrial

Kjo kategori është e nevojshme pasi objekti përfshin: Punime ndërtimore shoqëruese, si struktura betoni për ankorim dhe mbrojtje të tubacionit; Ndërtim civil ndihmës dhe elementë konstruktivë për garantimin e stabilitetit të linjës; Punime betoni dhe strukturore të lidhura me funksionimin afatgjatë të veprës.

Vendosja e kësaj kategorie lidhet drejtpërdrejt me realizimin teknik të objektit.

NP – 4 A – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale

Vendosja e këtij klasifikimi justifikohet pasi: Linja e transmetimit kalon dhe ndërhyr në zona ku ekzistojnë rrugë dhe segmente infrastrukturore; Gjatë punimeve kërkohet: çarje e trupit të rrugës, rikonstrukcion dhe rikthim i shtresave rrugore në gjendjen fillestare;

Punimet duhet të kryhen sipas standardeve të ndërtimit rrugor.

Kjo kategori është e domosdoshme për garantimin e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së infrastrukturës ekzistuese.

NP – 7 A – Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje

*Kjo kategori përbën **klasifikimin kryesor të objektit**, pasi: Objekti i kontratës ka të bëjë me rikonstrukcionin e linjës së transmetimit të ujit të pijshëm DN-900 mm; Kërkohet përvojë specifike në: montim tubacionesh me diametër të madh, instalim armaturash, testime presioni dhe dezinfektim; Linja ka karakter strategjik për furnizimin me ujë të pijshëm.*

Vendosja e kësaj kategorie është plotësisht e lidhur me objektin dhe qëllimin e kontratës.

NS – 1 A – Punime për prishje të ndërtimeve

Vendosja e kësaj kategorie justifikohet pasi realizimi i objektit përfshin: Prishje të kontrolluara të strukturave ekzistuese përgjatë gjurmës së tubacionit; Çmontim dhe heqje të linjës ekzistuese të amortizuar; Heqje të objekteve ndihmëse ose elementëve që pengojnë realizimin e punimeve të reja.

Punimet e prishjes janë të pandashme nga procesi i rikonstrukcionit dhe janë të domosdoshme për realizimin e veprës së re.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. Inxhinier Hidroteknik 1 (një)

Lidhur me stafin e mësipërm inxhinierik, çdo ofertues duhet të disponojë, si dhe duhet të paraqesë në tender, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, konkretisht: Kontratën e punës të vlefshme, diplomën përkatëse, si dhe të figurojnë në listpagesat respektive për tre muajt e fundit, sipas kodeve përkatëse të punësimit.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të paraqesë punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentim : Kërkesa për disponimin e personelit drejtues teknik, konkretisht Inxhinier Hidroteknik, vendoset për të garantuar drejtimin profesional, kontrollin teknik dhe zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate. Dokumentacioni shoqërues kërkohet për të vërtetuar angazhimin real dhe të ligjshëm të personelit, në përputhje me legjislacionin e punës dhe të sigurimeve shoqërore.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

Punonjes Staf Teknik

- | | |
|----------------------------------|-------------|
| - Hidraulikë | 1 (nje) |
| - Montator tubosh uji | 1 (nje) |
| - Punëtores ndërtimi te thjeshte | 8 (gjashtë) |

Për këta punonjës, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- *kontratën individuale të punës;*
- *si dhe të figurojnë në listpagesat respektive për tre muajt e fundit, sipas kodeve përkatëse të punësimit.*

Argumentim : Kërkesa për punonjës të kualifikuar dhe të specializuar lidhet drejtpërdrejt me nevojën për realizimin efikas dhe cilësor të punimeve në terren. Ky kriter garanton kapacitet operacional të mjaftueshëm për përmbushjen e kontratës brenda afateve të përcaktuara.

Hidraulikë – 1 (një)

Vendosja e kërkesës për një hidraulik justifikohet pasi: Objekti i kontratës ka të bëjë me rikonstrukcion të linjës së transmetimit të ujit DN-900 mm; Hidrauliku është i domosdoshëm për: montimin dhe lidhjen e tubacionit, instalimin e armaturave dhe pajisjeve hidraulike, kryerjen e testeve të presionit dhe kontrollin e funksionimit të linjës; Prania e një hidrauliku garanton zbatimin korrekt të standardeve teknike dhe funksionale.

Montator tubosh uji – 1 (një)

Kjo kërkesë justifikohet pasi: Vendosja e tubacioneve DN-900 mm kërkon aftësi të specializuara dhe përvojë praktike; Montatori i tubave të ujit është përgjegjës për: pozicionimin korrekt të tubave, realizimin e lidhjeve sipas specifikimeve teknike, sigurimin e hermeticitetit dhe qëndrueshmërisë së linjës; Ky rol është i domosdoshëm për cilësinë dhe sigurinë e punimeve.

Punëtorë ndërtimi të thjeshtë – 8 (tetë)

Vendosja e numrit të punëtorëve të ndërtimit të thjeshtë justifikohet pasi: Punimet përfshijnë volum të konsiderueshëm punësh manuale, si: asistencë në gërmime, shtrirje dhe mbulim tubacionesh, punime rikthimi të terrenit; Numri i kërkuar është proporcional me: gjatësinë e linjës, ritmin e punimeve, nevojën për respektimin e afateve të kontratës; Prania e këtij numri punëtorësh siguron mbarëvajtjen dhe realizimin në kohë të punimeve.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 10 persona, në listëpagesa sipas formularëve standart për sigurimet, për 3 muajt e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit ë fuqi (nëpërmjet formës elektronike).

Ky kriter përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentim : Vendosja e një minimumi të fuqisë punëtore aktive në listëpagesa për tre muajt e fundit ka për qëllim të sigurojë që operatori ekonomik disponon një strukturë funksionale dhe të qëndrueshme organizative për realizimin e kontratës, duke shmangur rreziqet e vonesave ose ndërprerjeve në zbatim.

*Vendosja e kërkesës për **fuqi punëtore minimale prej 10 (dhjetë) personash**, të evidentuar në listëpagesa për **3 (tre) muajt e fundit**, justifikohet për arsyt e mëposhtme:*

1. Natyra dhe volumi i punimeve

Objekti përfshin punime lineare në gjatësi të konsiderueshme, të cilat realizohen në faza të njëpasnjëshme, si: gërmime, montim tubacionesh DN-900 mm, punime ndërtimore shoqëruese, rikthim i terrenit dhe i infrastrukturës ekzistuese.

2. Nevoja për vazhdimësi në zbatim

Realizimi i këtyre punimeve kërkon angazhim të vazhdueshëm të fuqisë punëtore, për të: respektuar grafikun e punimeve, shmangur ndërprerje apo vonesa në zbatim, garantuar sigurinë teknike gjatë punimeve.

3. Përputhshmëria me stafin minimal teknik

Numri minimal prej 10 punonjësish është në përputhje me stafin teknik të kërkuar, konkretisht: hidraulikë, montator tubosh uji, punëtorë ndërtimi të thjeshtë, duke përfshirë gjithashtu personel mbështetës për realizimin e punimeve ndihmëse.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion/ kontratë shërbimi operatorit ekonomik.

Kërkohen të jene në dispozicion këto mjete pune:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamioncine me kapacitet mbajtes jo me shume se deri 1.5-3.5 Ton	Pronesi ose me qira	1 copë
2	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes (10 – 12) ton.	Pronesi ose me qira	1 copë
3	Ekskavator me zinxhire 5-25 ton	Pronesi ose me qira	1 copë
4	Mini ekskavator	Pronesi ose me qira	1 copë
5	Aparart saldimi	Pronesi ose me qira	1 copë

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike Operatori duhet të paraqesë:

- Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes.
- Për të gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës dhe objekti.
- Për mjetet e marra me qira që shënohen në regjistra publik, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikata për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).
- Për të gjithë mjetet dhe pajisjet e kërkuara të shoqërohen me foto.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentim : Kërkesa për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike të nevojshme është e domosdoshme për realizimin e punimeve objekt kontrate sipas specifikimeve teknike dhe afateve të përcaktuara. Dokumentacioni i kërkuar për pronësinë ose disponueshmërinë e mjeteve siguron verifikueshmëri dhe shmang deklarimet e pasakta.

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 **(ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes)
- b) Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015 **(ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes)
- c) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë për saldimet e materialeve likeorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 3834-2:2021 **(ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes)
- d) Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor ISO 39001:2015 **(ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes)
- e) Çertifikatën e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:2018 **(ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes)

Argumentim : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i

produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

ISO 14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. ISO 14001:2015 është menduar për përdorim nga një organizatë që kërkon të menaxhojë përgjegjësitë e saj mjedisore në një mënyrë sistematike që kontribuon në shtyllën mjedisore të qëndrueshmërisë. ISO 14001:2015 ndihmon një organizatë të arrijë rezultatet e synuara të sistemit të saj të menaxhimit mjedisor, të cilat ofrojnë vlerë për mjedisin, vetë organizatën dhe palët e interesuara.

ISO 14001:2015 është i zbatueshëm për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra, dhe zbatohet për aspektet mjedisore të aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve të saj që organizata përcakton se mund t'i kontrollojë ose ndikojë duke marrë parasysh perspektivën e ciklit jetësor.

ISO 3834-2:2021 siguron kontroll të plotë të cilësisë në proceset e saldimit të materialeve metalike, të cilat janë procese speciale dhe kritike për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e veprave. Zbatimi i këtij standardi garanton cilësi të certifikuar, redukton rrezikun teknik dhe siguron përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe kontraktuale në projektet e UKT.

ISO 45001:2018 përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, me qëllim parandalimin e aksidenteve dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve. Zbatimi i këtij standardi siguron kushte të sigurta pune, redukton rreziqet profesionale dhe garanton përputhshmëri me kërkesat ligjore në aktivitetet e UKT.

ISO 39001:2015 përcakton kërkesat për menaxhimin e sigurisë rrugore, me qëllim uljen e aksidenteve dhe rreziqeve gjatë përdorimit të mjeteve dhe lëvizjes së personelit. Zbatimi i standardit siguron rritje të sigurisë dhe përputhshmëri me kërkesat ligjore në aktivitetet e UKT.

2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi, ose marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin, ose autorizim distributori për materialet objekt prokurimi shoqëruar me certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skeda teknike të prodhuesit/ve, ku të dallohen qarte specifikimet teknike të saj. Në rastin e autorizimit të distributorit duhet paraqitur dhe marrëveshja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Secili nga dokumentat e paraqitura duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website në rast verifikimi nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentim : Kërkesa për autorizim nga prodhuesi ose distributori, si dhe për dokumentacion teknik shoqëruar, vendoset për të garantuar origjinalitetin, cilësinë dhe përputhshmërinë teknike të materialeve objekt prokurimi me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike.

Në të gjitha rastet kur përmendet certifikatë ,markë,emër i veçantë ,patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njesia e Prokurimit